



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
QENDRA E KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM



Raport 6-mujor për vitin 2022

***Ky raport përmbledh veprimtarinë e realizuar nga institucioni për pjesën e parë të vitit 2022, gjatë 6-mujorit janar-qershor.**

Përmbajtja

SHKURTESA.....	3
HYRJE.....	4
PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME.....	5
I. ZBATIMI I PLANIT Të RI-INTEGRIMIT.....	7
II. AKTIVITETE INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE RITJJA E KAPACITETEVE	9
III. KOMUNIKIMI STRATEGJIK	12
IV. BASHKËPUNIME ME PARTNERË NË NIVEL KOMBËTAR, RAJONAL, NDËRKOMBËTAR	12
V. AKTIVITETI RAPORTUES DHE MONITORUES	16

SHKURTESA

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	QKEDH
Parandalimi dhe Kundërshtimi i Ekstremizmit të Dhunshëm	P/KEDH
Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	Strategjia Kombëtare
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	MSHMS
Ministria e Brendshme	MB
Ministria e Mbrojtjes	MM
Ministria e Drejtësisë	MD
Ministria e Financës dhe Ekonomisë	MFE
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë	MASR
Organizata Ndërkombëtare për Migracionin	IOM
Angazhimi i Komunitetit Global dhe Fondi i Qëndrueshmërisë	GCERF
Komisioni Evropian	KE
Rehabilitimi dhe Ri- integrimi	R&R
Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social	IANS
Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore	AMVV
Vendim i Këshillit të Ministrave	VKM
Qendra Pritëse e Trajtimit të Rasteve të Rikthyer nga Siria dhe Iraku	Qendra Pritëse
Luftëtarëve të Huaj Terroristë	LHT
Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve	DPB
Autoritetin Kombëtar për Certifikim Elektronik	AKCESK
Instituti i Kërkimit të Krimin Ndër-Rajonal dhe të Drejtësisë së Kombeve të Bashkuara	UNICRI
Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes	CSDG
Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare	QNLQ
Organizata te Shoqërisë Civile	OSHC

HYRJE

Ky raport ka për qëllim të përmbledhë aktivitetin e periudhës gjashtë mujore janar – qershor 2022 të Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) dhe është hartuar duke evidentuar aktivitetet e kryera bazuar në objektivat institucionale.

QKEDH në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku” dhe VKM nr. 237 dt. 20/04/2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 737 dt. 13/12/2017 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”, është institucion nga data 20/04/2022 në varësi të Ministrisë së Brendshme së Republikës së Shqipërisë e angazhuar në koordinimin dhe monitorimin e punës me institucionet qendrore, vendore dhe partnerët ndërkombëtarë për proceset e parandalimit të radikalizmit, kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe pritjes dhe akomodimit të shtetasve të rikthyer nga zonat e konfliktit si dhe zbatimit të planeve të rehabilitimit dhe ri-integritimit. Drejtori Ekzekutiv, znj. Lejdi Dervishi është liruar nga detyra dhe me Urdhër n. 109 datë 20/06/2022 për emërim në detyrë të lëshuar nga Ministri i Brendshëm, z. Bledar Çuçi, është emëruar në detyrë z. Denion Meidani.

Lidhur me rastet të identifikuar dhe të raportuara ndaj institucioneve të ngarkuar me zbatimin e VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku”, QKEDH ka vijuar aktivitetin e grumbullimit të informacioneve, raporteve dhe koordinimin mbi zbatimin e procesit të ri-integritimit të 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riatdhesuan më datën 1 Gusht 2021 nga kampet e ish vendeve të konfliktit, Siri dhe Irak si dhe të 5 (pesë) shtetasve të riatdhesuar në 27 tetor 2020 nga këto vende (Siri dhe Irak), si dhe me realizimin e objektivave të Planit të Veprimit (P/CVE), Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 930, datë 18.11.2015 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe të Planit të Veprimit”, Vendimin nr.1137, datë 16.12.2020 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit” 2021–2025, dhe plani i veprimit 2021–2023, Planit të Veprimit Ndërinstitucional “Për pritjen dhe trajtimin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga zonat e konfliktit Siri/Irak” miratuar me Urdhrin nr. 169 të Kryeministrit, datë 1 nëntor 2018), Strategjisë Kombëtare për Sigurinë e Republikës së Shqipërisë, në fuqi nga Korriku 2014.

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Përgjatë pjesës së parë të vitit 2022 (janar - qershor), Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (në vijim QKEDH) ka vijuar të realizojë aktivitetin e saj koordinues ndër-institucional në parandalimin dhe kundërshtimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm duke zbatuar Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin Kombëtar të Veprimit (P/KEDH), ka vijuar zbatimin dhe monitorimin e procesit të katërt të riadhesimit të shtetasve shqiptarë të mbetur në kampet e vendeve të konfliktit, Siri dhe Irak; të procesit të ri-integrimit të personave të riadhesuar nga këto kampe në tetorin e vitit 2020, gusht 2021, maj 2022; si dhe realizimin e objektivave të Planit të Veprimit P/KEDH.

Gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti, dinamika e aktivitetit u fokusua në zbatimin e veprimtarisë së planifikuar në nivel qendror dhe vendor në bashkëpunim me partnerët apo aktorët e ndryshëm të shoqërisë për përbushjen e objektivave të Planit të Veprimit, si dhe tek procesi i ri-integrimit dhe ri-socializimit të shtetasve të riadhesuar për të treja fazat. Ky aktivitet përfshin:

- zbatimin e Planit të Veprimit në parandalimin e fenomenit;
- ndjekjen e procesit të koordinimit të të gjithë strukturave shtetërore për ri-integrimin dhe ri-socializimin në komunitet të 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riadhesuan më datën 01 Gusht 2021 dhe të 5 (pesë) shtetasve të parë shqiptarë që u kthyen nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak më datë 27.10.2020 si dhe monitorimi i riadhesimeve të fundit të cilët janë në fazën e rehabilitimit në Qendrën Pritëse, Durrës të kthyer me datë 27.05.2022;
- koordinimin e punës dhe orientimin e partnerëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, mbështetës të procesit të rehabilitimit, ri-integrimit dhe të ri-socializimit (RRR) të shtetasve të kthyer;
- hartimin e Planit të Veprimit për ekstremizmin e dhunshëm dhe inkorporimi i narrativës në Strategjinë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit ;
- promovimin dhe mbështetjen e rolit të shoqërisë civile në zbatimin e plotë të veprimit të P/KEDH-së në koordinim me institucionet e linjës;
- nxitjen e kontributit me ide – propozimet e kërkuara QKEDH-së, në kuadër të zbatimit të P/KEDH me qëllim tërheqjen e granteve të vogla të publikuara nga donatorët mbështetës të Qeverisë Shqiptare në fushën e P/KEDH; (Ref. OSHC-ve, Organizata të Shoqërisë Civile, lidhur me grantet e akorduara nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës);
- mbështetjen dhe promovimin e OSHC-ve shqiptare në kuadër të idesë së partnershipit publik-privat me qëllim forcimin e rolit të tyre, por edhe marrjen e fondeve të akorduara nga organizata ndërkombëtare GCERF (Angazhimi i Komunitetit Global dhe Fondi i Qëndrueshmërisë), me qëllim kontributin dhe impenjimin e OSHC-ve për të përfutur fonde të konsiderueshme ndërkombëtare në kuadër të zbatimit të P/KEDH në Shqipëri.

Në koordinim me Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, QKEDH mori pjesë në pritjen e 13 (trembëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riadhesuan më datë 27.05.2022 nga kampet e ish vendeve të konfliktit, Siri dhe Irak ku QKEDH koordinon fazat e procedurave ligjore, mjekësore, psiko-sociale dhe të rehabilitimit, të cilat zhvillohen në Qendrën Pritëse, ku janë akomoduar të rikthyerit e kësaj faze.

QKEDH në bashkërendim me Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve e Njësive Administrative (NJA) përkatëse, psikologë, përfaqësues të Shërbimit Ligjor Falas (TLAS) dhe Drejtorisë së Antiterrorit dhe strukturave të Policimit në Komunitet të Policisë së Shtetit, Rrjetin e Mësuesve Koordinatorë në nivel Kombëtar, Organizatat e Shoqërisë Civile, ka identifikuar dhe bashkërenduar punën për trajtimin e çështjeve të ekstremizmit të dhunshëm si dhe shfaqjeve të incidenteve të reja apo që rrjedhin nga situata të të rikthyerve, në fazë rehabilitimi apo në fazë ri-integrimi në komunitet.

I. ZBATIMI I PLANIT TË RI-INTEGRIMIT

Nën drejtimin e Ministrisë së Brendshme (MB), QKEDH mori pjesë në pritjen e 13 (trembëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riatdhesuan më datë 27.05.2022 nga kampet e ish vendeve të konfliktit, Siri dhe Irak. Këta shtetas, 9 (nëntë) fëmijë dhe 4 (katër) gra, fillimisht mbërritën në aeroportin “Adem Jashari” të Prishtinës së bashku me shtetas të tjerë kosovarë, dhe më pas u nisën për në Shqipëri.

Ministri i Brendshëm z. Bledi Çuçi, homologu i tij kosovar Z. Xhelal Sveçla, drejtuesit e policisë së të dy vendeve, Z. Gledis Nano e Z. Samedin Mehmeti, QKEDH dhe Divizioni për Parandalimin dhe Riintegrimin e Individëve të Radikalizuar, i pritën shtetasit shqiptarë dhe ata kosovarë në aeroportin e Prishtinës.

Riatdhesimi i 13 (trembëdhjetë) shtetasve shqiptarë shënoi finalizimin e operacionit të katërt të organizuar nga shteti shqiptar për riatdhesimin e shtetasve shqiptarë që gjendeshin në kampet e luftës në Siri.

Nën kujdesin e veçantë të punonjësve të QKEDH-së, 13 (trembëdhjetë) shtetasit shqiptarë u nisën nga aeroporti i Prishtinës drejt Shqipërisë të shoqëruar nga Policia e Shtetit. Trasferimi i tyre nisi pas kryerjes së kontroleve mjekësore paraprake, ndërkohë që QKEDH kishte kryer paraprakisht verifikimin e nevojave për këta shtetas pranë Qendrës Pritëse (QP) Durrës, ku u vendosën, si dhe të stafit që po punon pranë kësaj qendre.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga **VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021** “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku” për 13 (trembëdhjetë) shtetasit shqiptarë që u riatdhesuan më datë 27.05.2022 nga kampet e ish vendeve të konfliktit, Siri dhe Irak, 10 (dhjetë) fëmijë dhe 3 (tre) gra, të akomoduar në ambientet e Qendrës Pritëse (në Shtëpinë e Pushimit të Ushtrakeve, Durrës), faza e 4-të e riatdhesimeve vazhdon mbështetja gjithëpërfshirëse për plotësimin e nevojave të tyre, për përbushjen e suksesshme të fazës së rehabilitimit.

QKEDH-ja gjatë muajit Qershor koordinoi procesin e vlerësimit të dijeve dhe të të nxënit për fëmijët e moshës 5-17 vjeç, në ambientet e Qendrës Pritëse nga komisioni i ngritur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Vlerësimi i kryer në bazë të testeve, vrojtimit dhe pyetjeve që anëtarët e komisionit zhvilluan me fëmijët nxori rezultate pozitive për nivelin e aftësive të tyre të të mësuarit. Komisioni vlerësoi dhe vendosi regjistrimin e 10-fëmijëve të rikthyer në klasa përkatëse sipas sipas legjislacionit në fuqi për vitin akademik 2022-2023.

Në vijim të procesit në QP dhe të gjitha rezultateve të marra nga psikologët e Shërbimit Social mbi gjendjen e përfituesve u bë e mundur me mbështetjen e partnerit Terre de Homme, ofrimi i shërbimit shtesë me psikologe të jashtëm, me eksperience për moshat adoleshente për të trajtuar rastet e krizave dhe shpërthimeve emocionale, që disa prej të riatdhesuarve manifestonin, si pasojë e stresit post-traumatik. Me anë të këtij shërbimi psikologjia mbështetëse e specializuar për moshat adoleshente kërkoi shërbim më profesional nga një psikiatër ekspert për rehabilitim. Për të vijuar procesin me siguri dhe profesionalizëm u bë e mundur vënia në dispozicion e një psikiatri të specializuar nga partneri jonë mbështetës, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza. Aktualisht gjendja duket më e qetë dhe po mbahet nën kontroll.

Gjithashtu në javën e parë të Qershorit disa prej fëmijëve të rikthyer shfaqën simptomat e para të temperaturës, kollës dhe dhimbjes së kokës. Kjo situatë u rëndua pasi në një hark kohor të

shkurtër edhe fëmijët e tjerë shfaqë po të njëjtat simptoma. Për shkak të gjëndjes së krijuar u konsiderua e nevojshme nga mjekët specialist të kryheshin testimet për Covid-19 të të gjithë përfituesve dhe stafit në QP. Nga testimet e kryera rezultuan 8-të nga përfituesit pozitiv me virusin Covid-19.

Në këto kushte, pas konsultës me mjekun e qendrës u vendos që të gjitha familjet të karantinohen, së bashku me 4 pjesëtarë të stafit. Të gjithë të prekurit iu nënshtruan vizitës mjekësore, morën mjekimin e nevojshëm dhe u mbajtën në vëzhgim gjatë gjithë periudhës së karantinimit nën monitorimin e strukturave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. QP u karantina për një periudhë 1-javore bashkë me kujdestarë, psikologë, mjekë dhe punonjësit socialë. Pas përfundimit të periudhës së karantinimit e deri më tani gjendja aktuale është nën kontroll dhe pa problematika. Disa nga të prekurit po vazhdojnë mbështetjen me vitamino-terapi.

Në përmbushje të të gjithë procesit punohet njëkohësisht edhe me shërbimin ligjor i cili është mundësuar dhe vazhdon mbështetjen nga Tirana Legal Aid Society (TLAS) mbështetur financiarisht nga UNICEF. Ky proces është kompleks dhe dinamik për nga natyra sensitive dhe statusi që përfituesit mbartin që prej largimit të tyre. Gjendja aktuale që prej rikthimit të parë e deri në riatdhesimet e fundit është si më poshtë:

Gjithsej janë hapur 37 (tridhjetë e shtatë) çështje për të cilat TLAS-si ofron shërbimin ligjor për personat e kthyer. Duke qenë se procesi i regjistrimit të fëmijëve zgjat në kohe sepse nevojitet të vërtetohet amësia nga rezultati i analizës së ADN-së, 28 (njëzet e tetë) prej çështjeve vazhdojnë të jenë në proces ndërsa 9 (nëntë) të tjera janë të përfunduara me sukses, nga të cilat 2 (dy) çështje të regjistrimit të fëmijëve të kthyer në fazën e parë të riatdhesimit.

Përfituesit gjatë proceseve gjyqësore kanë si përfaqësues të tyre avokatët mbështetës të TLAS si dhe marrin asistencë ligjore familjare të vazhdueshme.

Përmes koordinimit paraprak të QKEDH-së me institucionet e përfshira në procesin e Rehabilitimit dhe Ri-integrimit, për këta shtetas ka nisur zbatimin e procesit të ri-integrimit sipas modelit të konsoliduar pranë strukturës së QP-së të ngritur për këtë qëllim, e cila operon me një staf multidisiplinar të trajnuar profesionalisht dhe me përvojë.

QKEDH ka koordinuar dhe ka dërguar pranë Ministrisë së Mbrojtjes (MB) listën paraprake të të gjithë strukturës së ngritur në Qendrën Pritëse si dhe ka koordinuar me Shërbimin Social Shtetëror të gjitha nevojat e krijuara imediate në strukturat e QP-së që lidhen me përmbushjen e procesit të rikthyerve në këtë fazë të 4-të.

Plani i ri-integrimit përfshin edhe zbatimin e procesit të ri-integrimit të 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riatdhesuan më datën 1 Gusht 2021 dhe të 5 (pesë) shtetasve të riatdhesuar nga zonat e konfliktit më datë 27.10.2020.

QKEDH përfundoi edhe realizimin e 6 (gjashtë) trajnimeve me mësuesit e shkollave në Tiranë të cilat ofrojnë shërbime për fëmijë të rikthyer nga zonat e konfliktit. Trajnimet që u mbështetën nga LKGV nëpërmjet grantit të GCERF, përcollën informacionin e nevojshëm në lidhje me qasjen që duhet përdorur me këtë kategori fëmijësh duke theksuar bazën ligjore, qasjen psikologjike si dhe mënyrat e bashkëpunimit me struktura të pushtetit vendor të angazhuara në procesin e ri-integrimit.

QKEDH me bashkëpunim me misionin e organizatës Terre des Hommes (TdH) dhe me mbështetjen financiare GCERF kanë zhvilluar dy trajnime për psikologët, pjesë e Njësisë të shërbimit psiko-social në shkollat të cilët zbatojnë programe mbështetëse për fëmijët e rikthyer nga

zona të luftës me temë: “Teknikat e terapisë së artit” në kuadër të projektit ”Parandalim dhe ri-integrimit i sigurt: Qasje holistike dhe e qëndrueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm” i cili u zbatua në rajonet Tirana dhe Durrësi, Dibra, Korça, Elbasani dhe Kukësi.

Gjithashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të stafit psiko-social të bashkisë Vlorë për menaxhimin e rasteve EDH, QKEDH zhvilloi trajnimin me temë: “Mbi menaxhimin e procesit të rehabilitimit dhe ri-integrimit të Shtetasve Shqiptarë të kthyer nga zonat e konfliktit Siri-Irak” me mbështetjen e organizatës LKGV.

QKEDH ka zhvilluar trajnime për ngritjen e kapaciteteve në nivel qendror dhe vendor dhe për strukturat e përfshira drejtpërdrejtë në këtë proces, janë zhvilluar takime me synim informimin mbi ecurinë e ri-integrimit të rasteve dhe për të koordinuar më pas nevojat e identifikuar. QKEDH ka marrë në shqyrtim raportime periodike vlerësuese mbi ecurinë e procesit nga psikologët dhe Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) që ndjekin rastet në kuadër të zbatimit të këtij procesi.

QKEDH ka koordinuar dhe realizuar një takim online me PMF-të pranë Bashkisë Tiranë që janë angazhuar me menaxhimin e këtyre shtetasve ku u diskutua mbi monitorimin e procesit që po realizohet.

Sërish si rezultat i bashkëpunimit me PMF-të e Njësisë Administrative (NJA) përkatëse, QKEDH ka organizuar tre takime individuale me shtetasit e riatdhesuara nga ish vendet e konfliktit Siri dhe Irak ku morën pjesë edhe përfaqësues të Shërbimit Ligjor Falas (TLAS) dhe ata të Drejtorisë së Antiterrorit, ku shtetasit në fjalë u njohën me procesin ligjor që po zhvillohet si dhe me detyrimet që ato kanë.

Për secilin prej rasteve të sipërshkruar ka vijuar mbështetja e organizatave bashkëpunuese zbatuese në këtë proces me paketa ushqimore periodike, me pagesën e ujit dhe dritave sipas rasteve që e kanë shfaqur si nevojë, apo dhe për të tjera si nevoja të identifikuar.

Punonjësit e Mbrojtjes për Fëmijë (PMF) që janë menaxherë të rasteve kanë monitoruar proceset e zhvilluara për njësitë familjare të këtyre shtetasve. Psikologët kanë kryer seancat këshilluese në kuadër të terapisë që zbatohet si për nënat dhe të miturit.

II. AKTIVITETE INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE RITJA E KAPACITETEVE

Me urdhër të Kryeministrit Nr. 59, datë 1.04.2022, u miratua Rregullorja e Brendshme e Institucionit të QKEDHS-së “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”.

QKEDH dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit për realizimin e veprimtarisë së përbashkët në kuadër të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut në përputhje me standartet e njohura ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm. Gjithashtu, QKEDH mori pjesë në Forumin e Gjashtë Ndër-institucional për P/KEDH që u organizua në bashkëpunim me Institutin për Aktivizëm dhe Ndryshim Social (IANS) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve në qytetin e Fierit, gjatë të cilit u diskutua mbi rëndësinë e angazhimit të përbashkët ndër-institucional në parandalimin e fenomenit brenda sistemeve të brendshme të burgjeve dhe Shërbimit të Provës.

Fillimi i këtij viti e gjeti QKEDH të angazhuar në projektin “Mbështetja e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në përhapjen e komunikimit strategjik për P/KEDH nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve dhe hulumtimit”. Në këtë kontekst, institucioni ynë u ridërgoi pikave të

kontaktit pranë ministrive të linjës kërkesën për përcaktimin e datave dhe personave përgjegjës mbi zhvillimin e takimeve dhe trajnimeve në kuadër të këtij projekti.

QKEDH ka zhvilluar një takim informues–ndërgjegjësues me nxënësit e dy shkollave 9-vjeçare në Shkodër dhe aktorëve të vijës së parë pranë këtyre shkollave në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, që u zhvillua në bashkëpunim me Shoqatën Internacionale për Solidaritet (SHIS).

QKEDH ka realizuar 23 (njëzet e tre) takime/ tryeza pune me palë të treta dhe trajnime në kuadër të rritjes së kapaciteteve me një pjesëmarrje prej 183 (njëqind e tetëdhjetë e tre) pjesëmarrësish.

Në kuadër të bashkëpunimit me palët e treta, QKEDH me organizatën Qendra e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë (WCDCA) ka realizuar tre trajnime me temë “Edukimi i fëmijëve nëpërmjet prindërimit pozitiv” në qytetet Lushnje, Fier, Berat në kuadër të projektit “Nënat të parat” qëllimi kryesor i të cilit u bazua tek fuqizimi i nënave për aftësimin e tyre për prindërim pozitiv.

Po në kuadër të bashkëpunimit me palë të treta, QKEDH ka zhvilluar një takim me Institutin e Ndërmjetësimit të Demokracisë (IDM) për hartimin e metodologjisë së kërkimit me qasje analizimin e perceptimit të popullatës mbi qëndrueshmërinë e komuniteteve në Postribë, Himarë, Dropull, Prespë dhe zonat përreth tyre si dhe gatishmërinë e tyre për të mirëpritur individë të rikthyer nga zonat e konfliktit në komunitetet e tyre.

Në vijim të procesit të Rehabilitimit, Ri-integrimit dhe Risocializimit (R&R&R) që po zbatohet në vend dhe në kuadër të trajnimit të mësuesve në shkollat ku mësojnë fëmijë të rikthyer gjatë fazës së dytë të riatdhesimit nga zonat e konfliktit, QKEDH në bashkëpunim me ZVA Tiranë ka realizuar një trajnim me mësuesit e shkollës “Niket Dardani” Tiranë ku janë ri-integruar 3 (tre) fëmijë të rikthyer më 1 Gusht 2021. Trajnimi përcolli informacion mbi qasjen që duhet përdorur me këtë kategori fëmijësh.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve të punonjësve të stafit, QKEDH ka marrë pjesë në dy trajnimet e zhvilluar online nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) me temë: ‘Ndihma juridike falas dhe grupet vulnerable’ i fokusuar tek metodologjia e dhënies së ndihmës juridike falas për shtetasat vulnerable si dhe “Udhërrëfyesi për shoqërinë civile dhe roli i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë civile në këtë proces” ku u ligjërua mbi rolin e agjencisë për mbështetjen e shoqërisë civile, fushat ku operon agjencia dhe mbi masat e ndërmarra nga qeveria për një mjedis mundësues, ‘Deklarimi on-line i pasurive në sistemin elektronik’, ‘Fundamental of the EU legal & institutional System & overview of the legal enlargement process’. Gjithashtu, QKEDH ka qenë pjesëmarrëse në trajnimin e organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) me titull: ‘Përgatitja e PBA 2023-2025 sipas perspektivës së buxhetimit të përgjithshëm gjinor’.

QKEDH ka marrë pjesë në trajnimin e mbajtur online “Përgatitja e strukturës së negociatave shqiptare për hartimin e Udhërrëfyesit të BE-së për Kapitullin 24” i cili synoi të mundësonte njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për pjesëmarrësit për hartimin e politikave, strategjive, programeve dhe projekteve për të lehtësuar rrugën drejt integrimit në BE

QKEDH ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me Rektoratin e Universitetit të Tiranës (UT). Marrëveshja e Bashkëpunimit u nënshkrua nga Rektor i UT-së dhe Drejtori i QKEDH-së. Gjithashtu, QKEDH ka nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë në kuadër të përcaktimit të fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit për realizimin e Strategjisë Kombëtare “Për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit”.

Po në kuadër të bashkëpunimit në nivel akademik, QKEDH ka organizuar dy forume me studentët dhe pedagogët e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë në Universitetin “Ismail Qemali”

në Vlorë dhe të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Ndërkombëtare (AIIS) në kuadër të projektit “Universitetet- Fronti i ri i angazhimit CVE” që mbështetet nga Ambasada e SHBA-ve ku u prezantuan qëllimet e projektit, konceptet bazë të QKEDH-së si dhe objektivat e strategjisë kundër EDH në Shqipëri.

QKEDH ka kontribuar në tre trajnime të organizuara nga CSDG ALBANIA me mbështetjen e Ambasadës së SHBA-ve në Shqipëri, për ndërtimin e kapaciteteve për komunikimin strategjik si mjet për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Në periudhën raportuese u mundësua procesi i mentorimit të katër (4) studenteve të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, të ciklit Master Profesional Ndërdisiplinor “Administrim i Institucioneve Sociale në Sistemin e Drejtësisë”, të cilët zhvilluan praktikën mësimore pranë institucionit.

Në përmbushje të ndërgjegjësimit dhe rritjes së kapaciteteve në parandalimin dhe kundërshtimin e fenomenit të Ekstremizmit të Dhunshëm, QKEDH ka marrë pjesë me kontribute aktive në gjashtë sesione informuese, konkretisht leksioni i hapur i zhvilluar me studentët e Universitetit Mesdhetar dhe 9 (nëntë) takime mentoruese me studentët që kryen praktikën profesionale pranë QKEDH-së. Gjithashtu, janë zhvilluar 7 (shtatë) tryeza pune me palë të treta ku kanë marrë pjesë 72 (shtatë e dhjetë e dy) pjesëmarrës dhe tre trajnime për rritje kapacitetesh, dy prej të cilave online.

QKEDH ka marrë pjesë në workshopin rajonal që organizoi Rrjeti Rajonal i Koordinatorëve Kombëtarë për Planin e Veprimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Ballkanin Perëndimor (RNNC), si dhe u bë pjesë e trajnimit “Traumat dhe ndërhyrjet terapeutike” që u zhvillua për psikologët organizuar nga TdH me mbështetjen e GCERF. Gjithashtu, QKEDH ishte pjesëmarrëse në trajnimin e organizuar nga Radicalization Awareness Network (RAN), “Bashkëpunimi Pedagogjik në Lagje” ku u përcoll modeli i Holandës në kuadër të angazhimit të fëmijëve në çështje me rendësi për lagjen, përfshirë edhe vendimmarrjen.

QKEDH ka koordinuar me organizatën Qendra për Studimin e Demokracisë (CSDG) për zhvillimin e trajnimit për personelin kyç të institucioneve që janë të përfshirë në zbatimin e P/KEDH dhe në proceset e ri-integrimit të shtetasve të riatdhesuar nga vendet e konfliktit me fokus komunikimin strategjik, në kuadër të projektit “Mbështetja e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të dhunshëm në përhapjen e komunikimit strategjik për P/KEDH nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve dhe hulumtimit” që zbatohet nga CSDG me mbështetjen e Ambasadës së SHBA-së në Shqipëri.

QKEDH ka koordinuar procesin e trajnimit me psikologët e Shërbimit Social Shtetëror i mbështetur nga TdH, si dhe ka zhvilluar një takim me drejtorin e këtij institucioni, gjatë të cilit u diskutua mbi nevojat dhe problematikat në vazhdim për personat e kthyer nga zonat e konfliktit.

Po në kontekstin e procesit ri-integrues që po zbatohet, QKEDH ka zhvilluar një takim me përfaqësues të Institutit për Ndërmjetësim Demokratik me fokus diskutimin e projektit EUTEX, gjatë të cilit përfaqësuesi i QKEDH-së ka dhënë një intervistë mbi vlerësimin e efektshmërisë dhe përputhshmërisë së qasjeve të përdorura për rehabilitimin/ri-integrimin e të kthyerve nga Siria dhe të dënuarve për ekstremizëm të dhunshëm në Shqipëri.

QKEDH ka realizuar 4 (katër) seanca mentoruese me studentet e Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, të master Profesional Ndërdisiplinor “Administrim i Institucioneve Sociale në Sistemin e Drejtësisë” dhe Fakultetit e Shkencave të Krimnologjisë në Universitetin “Marlin Barleti” të cilët ndoqën zhvillimin e praktikës mësimore pranë institucionit, në kuadër të

Marrëveshjes së bashkëpunimit me Departamentin e Sociologjisë në Fakultetin e Shkencave Sociale U.T nr. Prot. 20/3 dt. 09/02/2022.

III. KOMUNIKIMI STRATEGJIK

Në periudhën raportuese Radio Televizioni Publik Shqiptar (RTSH) transmetoi Episodet 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të ciklit të reportazheve që ka realizuar Qendra Media Aktive me koordinimin dhe bashkëpunimin e Qendrës CVE mbi evidentimin e bashkëpunimit kundër fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm ndërmjet institucioneve të shtetit shqiptar, shoqërisë civile dhe komuniteteve fetare.

Në përmbushje të objektivit Komunikimi Strategjik dhe në funksion të transparencës mbi aktivitetin që kryen, QKEDH ka publikuar 107 materiale informuese mbi këtë aktivitet, nga të cilat 32 janë publikime në faqen zyrtare Web, 53 në rrjetin social Twitter dhe 22 publikim në LinkedIn.

Po gjatë periudhës raportuese, QKEDH koordinoi dhe realizoi dy intervista me individë të rikthyer nga zonat e konfliktit të cilët po ndjekin programe rehabilituese/ri-integruese në komunitet, të mbështetura nga QKEDH-ja.

QKEDH dha kontributin e saj nëpërmjet një interviste në Emisionin Auditor Arsimit në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH), gjatë së cilës u përcoll informacion mbi ndërhyrjet e realizuara përgjatë këtyre viteve nga QKEDH në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) në sistemin parauniversitar dhe universitar për identifikimin, parandalimin dhe kundërshtimin e EDH-së si dhe tek ri-integrimi i fëmijëve të rikthyer nga zonat e konfliktit në shkollë dhe komunitet.

IV. BASHKËPUNIME ME PARTNERË NË NIVEL KOMBËTAR, RAJONAL, NDËRKOMBËTAR

Në mënyrë paralele me zbatimin e P/KEDH dhe Procesin R&R&R, QKEDH ka vijuar punën në kuadër të procesit të hartimit të Planit të Veprimit 2022-2024 për ekstremizmin e dhunshëm dhe inkorporimi i narrativës në Strategjinë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit. Institucioni ynë përcollti pranë Ministrisë së Brendshme draft- matricën përfundimtare të Planit të Veprimit dhe komentet në draft- Strategjinë e re Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit.

QKEDH zhvilloi një takim me përfaqësues të Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) pasi është angazhuar në projektin “Mbështetja e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në përhapjen e komunikimit strategjik për P/KEDH nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve dhe hulumtimit”. Me qëllim vlerësimin e nevojave për trajnim për përmirësimin e kapaciteteve të punonjësve të ministrive respektive të linjës mbi zhvillimin dhe zbatimin e komunikimit strategjik për parandalimin dhe kundërvënien e propagandës së dhunshme ekstremiste, QKEDH ka zhvilluar katër takime, specifikisht me përfaqësues të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, të Shërbimit të Provës, të Ministrisë së Drejtësisë, të Policisë së Shtetit, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) dhe të MB.

Në nivel kombëtar, QKEDH i dhuroi Drejtorisë së Antiterrorit (DAT) pajisjet kompjuterike me të cilat punonjësit e DAT punuan mbi procesin ri-integrues të familjeve të kthyer nga zonat e konfliktit me 1 gusht 2021.

Po në kontekstin e bashkëpunimit me institucionet në vend, QKEDH ka dërguar pranë Policisë së Shtetit dhe Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH) shkresën zyrtare ku i informon mbi vendbanimet në komunitet të 5 familjeve (5 nëna dhe 14 fëmijë) që u kthyen më 1 gusht 2021 nga kampet në zonat e konfliktit, Siri dhe Irak si edhe mbi shkollat ku janë rregjistruar fëmijët me moshë shkollore, në kuadër të procesit të ri-integrimit që po zhvillohet.

Përsa i përket bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, QKEDH ka marrë pjesë në takimet me përfaqësues të Bashkimit Evropian (BE) në vend në kuadër të projektit : “Ndërtimi i kapaciteteve institucionale në Ballkanin Perëndimor për të përballuar sfidat që lidhen me riintegrimin, risocializimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj terroristë (LHT) dhe familjet e tyre të kthyer nga zonat e konfliktit” që po implementohet nga IOM në Shqipëri me mbështetjen financiare të BE.

Në kuadër të pëmbushjes së këtij objekti, QKEDH ka marrë pjesë në 28 takime/tryeza pune me qëllim nxitjen e aktivitetit në pëmbushje të misionit që ka institucioni.

Në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian/ Këshillit të Evropës të mbështetjes horizontale për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022, QKEDH në bashkëpunim me Institutin për Aktivizëm dhe Ndryshim Social (IANS) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB) organizuan forumin e parë ndër-institucional mbi aspektet e rehabilitimit dhe ri-integrimit e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm dhe të radikalizuar në sistemin penitenciar shqiptar.

Po në këtë drejtim QKEDH kontribuoi në grupin e punës: "Zhvillimi i mjeteve të ndërhyrjes dhe rehabilitimit për trajtimin e radikalizmit në burgje" në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve për adresimin e radikalizmit në burgje në BP, mbështetur nga programi i përbashkët BE/KE për BP dhe Turqinë 2019-2022. ku morën pjesë aktore te vijës së pare në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në të cilat aktualisht ka të burgosur për çështje Radikalizmi dhe Ekstremizmi të Dhunshëm.

QKEDH mori pjese në konferencën me temë “Rishikimi dhe perspektivat e parandalimit të radikalizmit në Evropë” organizuar nga Ministria franceze për Evropën dhe Punët e jashtme, në kuadër të Presidencës franceze të Këshillit të Bashkimit Evropian që u mbajt në Paris, nga 24-25 Shkurt 2022, me qëllim mbështetjen e përpjekjeve për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet vendeve të BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor për parandalimin e radikalizmit, hedhjen dritë mbi sfidat kryesore në fushën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm si dhe shkëmbimin e praktikave me të ndjekura të vendeve pjesëmarrëse.

QKEDH kontribuoi si pjesëmarrëse në Forumin e Politikës së Jashtme me temë “Franca, Presidenca e BE-së dhe perspektiva për Ballkanin Perëndimor” e cila u organizua nga Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare (AIIS), si edhe edhe në takimin e zhvilluar online nga përfaqësues të BE-së që u fokusua në procesin e ri-integrimit që po zhvillohet në vendin tonë, ku u theksua rëndësia e mbështetjes dhe bashkëpunimit ndërmjet shtetit shqiptar dhe BE-së në pëmbushjen me sukses të këtij procesi.

E rëndësishme është edhe marrja pjesë në punimet e Konferencës “Vëllazëria në Humanizëm” që u organizua nga Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë (KNFSH) ku ishte e pranishme edhe ambasadori i SHBA-ve Yuri Kim, liderët e komuniteteve fetare në vend, të gruas dhe rinisë ndër-fetare, si dhe Presidenti i Këshillave Ndër-fetarë të Europës .

Gjithashtu, QKEDH ka kontribuar në takimin e dymbëdhjetë të Komitetit të Stabilizim- Asociimit Bashkimi Evropian – Shqipëri i cili monitoron zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit

dhe plotësimin e kritereve të anëtarësimit në BE ku u ndal në zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit për Luftën kundër Terrorizmit si një prej pikave të raportimit në kuadër të Kapitullit Drejtësia, Liria dhe Siguria.

Në kuadër të përmbushjes së këtij objekti është edhe bashkëpunimi me ambasadat e akredituara në vend ku evidentohet takimi i znj. Dervishi me Atasheun Ushtarak Francez pranë Ambasadës Franceze në vend dhe me Oficerin Ndërlidhës për Migracionin pranë kësaj ambasade, i fokusuar rreth çështjeve të forcimit të bashkëpunimit mes palëve në kundërshtimin e propagandës on line për radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm, si dhe zhvillimi i takimit me një delegacion të Mbretërisë së Bashkuar i fokusuar në çështjet e bashkëpunimit rajonal, bilateral midis palëve, fuqizimi i të rinjve për konceptet e sigurisë për mbrojtjen e të drejtës së lirisë së fjalës, si dhe kërcënimin për sigurinë që sjell fenomeni i radikalizmit.

QKEDH u bë pjesë e takimit online që u zhvillua nga Rrjeti i Qyteteve të Forta me fokus “Rehabilitimi dhe ri-integrimi i familjarëve të luftëtarëve të huaj terroristë” ku u diskutua mbi eksperiencën e Kazakistanit lidhur me problematikat dhe politikat e ndjekura me familjet dhe luftëtarët e rikthyer nga Siria dhe Iraku; ka zhvilluar tre takime me përfaqësues të DPB-së, të MAS dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) në kuadër të projektit “Mbështetja e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në përhapjen e komunikimit strategjik për P/KEDH nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve dhe hulumtimit” që zbatohet nga CSDG dhe po realizohet për përmirësimin e kapaciteteve të punonjësve të ministrive respektive të linjës.

Vlen të theksohet edhe fakti se QKEDH ka marrë pjesë në takimin e dytë të grupit ndër-institucional të punës për hartimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare e cila u zhvillua pranë Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme (MEPJ). QKEDH dha ndihmesën e saj paraprake në zërat përkatës që përfshihen në këtë strategji si kundërshtimi i radikalizimit apo ekstremizmit të dhunshëm.

Në kuadër të bashkëpunimit në nivel rajonal, QKEDH ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Prishtinë nga data 30 mars-1 prill në kontekstin e ngritjes së sistemit të digjitalizimit dhe menaxhimit të të dhënave të personave të kthyer nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak nga Shërbimi i Këshillimit dhe Referimit të Informacionit, i fokusuar mbi përfitimet dhe lehtësitë që sjell modeli i softuerit Information Counseling and Referral Services (ICRS) që po zbatohet në Kosovë. Gjatë kësaj vizite, u kryhen takime me homologët kosovarë në MB.

QKEDH ka zhvilluar një takim me Atasheun e Sigurisë dhe Këshilltarin për projektin e Ballkanit Kibernetik me të cilin diskutoi mbi fenomenin dhe projektet e ardhshme në lidhje me aktivitetet online dhe trajnimin/monitorimin kibernetik si dhe ekspertizën për çështjet e lidhura me sigurinë, si dhe me përfaqësuesin e programit ROM për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë mbi zbatueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e projektit “ROM - C-416539 – “Ndërtimi i kapaciteteve institucionale për t'u marrë me sfidat që lidhen me riintegrimin” i cili u zbatua në bashkinë e Cërrikut.

Gjithashtu, QKEDH ka koordinuar dhe organizuar takimin online me përfaqësues të projektit HOPE në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit që QKEDH ka nënshkruar. Projekti synon të zhvillojë një rrjet trajnimesh dhe shkëmbim të eksperiencës në vendet e Ballkanit, me qëllim përmirësimin e procesit të kalimit të të burgosurve nga mjediset e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në komunitet pas lirimit të tyre.

Në kuadër të bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, QKEDH ka zhvilluar një takim online me përfaqësues të Institutit Ndër-rajonal të Kombeve të Bashkuara për Kërkimet në Fushën e Drejtësisë dhe Krimin (UNICRI) me qëllim rishikimin e kuadrit të programit strategjik për periudhën 2023-2026.

QKEDH ka dhënë kontributin e saj edhe në Forumin e Tetë Ndër-institucional për Parandalimin dhe Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm të organizuar nga IANS dhe mbështetur nga Këshilli i Evropës ku mori pjesë edhe Ministria e Drejtësisë mbi qasjen ndërinstitucionale për proceset RRR.

QKEDH ka marrë pjesë në aktivitetin përmbyllës të Konferencës Kombëtare “Promovimi i Shkollës Qendër Komunitare” që u organizua nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim e mbështetur nga Ambasada e SHBA-së në Tiranë; si dhe në konferencën dy ditore "Parandalimi dhe kundërshtimi i Ekstremizmit të dhunshëm në Ballkan, Evropën jugore dhe lindore: Nevojat prezente dhe hapat për të ardhmen" e cila u mbajt nga Drejtoria e Përgjithshme e Ekzekutimit të Dënimeve Bullgari, në kuadër të projektit Holistic Radicalisation Prevention Initiative (HOPE).

QKEDH ka marrë pjesë në takimin rajonal të Koordinatorëve Kombëtarë CT-P/CVE (RNNC) të Ballkanit Perëndimor që u mbajt në Tiranë, ku u ndanë eksperiencat e vendeve të rajonit si dhe u diskutua për vijueshmërinë e bashkëpunimit të kuadër të parandalimit të fenomenit dhe ri-integrimit të individëve të rikthyer nga zonat e konfliktit.

QKEDH ka marrë pjesë në një vizitë studimore dy ditore në Berlin me teme "Vizitë studimore në menaxhimin e rasteve dhe familjet e tyre të kthyer nga zonat e konfliktit". Vizita u organizua nga RAN ku u prezantua procesi R&R dhe menaxhimi i tyre nga shteti gjerman dhe ndarja e praktikave me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu ka kontribuar në takimin e 3-të dy-ditor të grupit të punës të organizuar nga Këshilli i Evropës për zhvillimin e mjeteve të ndërhyrjes dhe rehabilitimit për trajtimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në burgje ku u prezantua drafti i parë i mjetit të Vlerësimit të Rrezikut dhe Nevojave për Ekstremizmin e Dhunshëm në burgjet në Shqipëri.

Gjithashtu, janë zhvilluar dy takime pune me Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR) të cilat u fokusuan në mundësinë e bashkëpunimit ndër-institucional për çështje me interes të përbashkët në fushën e rinisë, si dhe mbi veprimtarinë e AKR-së dhe QKEDH-së, një takim me përfaqësues të organizatës UNICEF në vend për bashkëpunimin dhe vijimin e mbështetjes së proceseve të R&R&R që po zhvillohen në vendin tonë. QKEDH zhvilloi takimin me përfaqësues të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe ekspertët për të diskutuar mbi metodologjinë e hartimit të modulit “Hartëzimi i programeve të rehabilitimit & ri-integrimit (R&R) për personat e kthyer nga zonat e konfliktit” i cili synon të rris kapacitetet e punonjëseve të vijës së parë, dhe një takim koordinues me përfaqësues të organizatave LKGV dhe Adriapol mbi aktivitetet në kuadër të projektit “Ri-integrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, i cili po zbatohet në Shqipëri me mbështetjen financiare të GCERF.

QKEDH ishte pjesëmarrëse në konferencën rajonale “Drejt praktikave të përmirësuara në parandalimin e radikalizimit dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje dhe trajnimin e stafit në Ballkanin Perëndimor” ku referoi për çështjen e sfidave të ardhshme të Ballkanit Perëndimor në lidhje me kthimin e luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre, me fokus në rastet që mund të procedohen përmes sistemit të drejtësisë penale. Gjithashtu, QKEDH ka marrë pjesë në punimet e seminarit “Identifikimi i nevojave, sfidave dhe zgjidhjeve për menaxhimin pas daljes nga burgju dhe bashkëpunimi ndër-institucional në fushën e de-radikalizimit, ri-integrimit

dhe rehabilitimit të dënuarve ekstremistë” që u organizua nga Projekti EUTEX dhe u financua nga Komisioni Evropian.

QKEDH mori pjesë në “Konferencën e tretë Rajonale për kundërshtimin e Dezinformimit në Ballkanin Perëndimor” punimet e së cilë u zhvilluan online si dhe u bë pjesë e aktivitetit prezantues të Platformës Kombëtare në Internet “Raporto Krimet dhe Gjuhën e Urrejtjes” e realizuar nga Platforma Kombëtare për Internet të Sigurt ISIGURT.AL në bashkëpunim me Ambasadën PINK Shqipëri dhe mbështetjen e Qendrës për të Drejtat e Fëmijëve (CRCA/ECPAT).

Gjithashtu, QKEDH është takuar me përfaqësues të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) për diskutimin e projektit SMART Ballkans-Shoqëria civile për vlera të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor; me zv/ rektorin e Universitetit të Tiranës për organizimin e konferencës rajonale rreth ndërhyrjeve të kryera nga universitetet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në universitete ku u dakordësua mbi modalitetet logjistike në kuadër të bashkëpunimit institucional për zhvillimin e konferencës në fjalë; me Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) të cilat janë pjesë e projektit të GCERF.

Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm ka qenë bashkë-organizatore e konferencës së Nivelit të Lartë Shqipëri–BE-GCERF “Përgjigja ndaj sfidës së rehabilitimit dhe ri-integrimit për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm më 15 Qershor 2022”, me Fondin Global të Angazhimit dhe Reziliencës së Komunitetit (GCERF) dhe Bashkimin Evropian.

Prej muajit Shkurt 2022, në cilësinë e shtetit partner në Ballkanin Perëndimor, pjesë e Bordit Drejtues është edhe Shqipëria pas identifikimit të saj si një shtet me një Qendër të cilësuar si model në parandalimin e radikalizmit dhe kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm. GCERF në koordinim me QKEDH organizoi për herë të parë Mbledhjen e Bordit në Shqipëri dhe Konferencën vijuese me përfaqësues nga 70 vende të botës në datat 14-16 Qershor 2022.

Krahas mbledhjes së Bordit dhe me bashkë-organizmin e Qeverisë së Shqipërisë, të përfaqësuar nga QKEDH, dhe Bashkimit Evropian është mbajtur takimi i nivelit të lartë ku gjithë anëtarët e Bordit morën pjesë me përfaqësues të lartë të qeverisë dhe shoqërisë civile. Donatorët e GCERF kanë qenë të pranishëm dhe patën rastin të konfirmojnë ndërmarrjen e angazhimeve të reja si pjesë e procesit të granteve dhe mbështetjes së GCERF për proceset R&R&R në Shqipëri.

V. AKTIVITETI RAPORTUES DHE MONITORUES

Në kuadër të përmbushjes së këtij objekti dhe detyrimit raportues institucional, QKEDH ka kryer një aktivitet të ngjeshur raportues. Janë 114 (njëqind e katërbëdhjetë) raportime/monitorime nga të cilat 50(pesëdhjetë) prej tyre mbi zbatimin e Planit të Veprimit dhe 44 (dyzet e katër) për zbatimin e Planit të Ri-integrimit për shtetasit e riatdhesuar.

Në kuadrin e këtij objekti evidentohen disa prej tyre, QKEDH:

- përcolli pranë ILDKPKI raportin vjetor mbi veprimtarinë e kryer nga institucioni ynë në zbatim të ligjit nr: 9367 dt. 07. 04. 2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- përcolli pranë MEPJ kontribut për raportimin mbi zbatimin e Planit të Përbashkët të veprimit për Luftën Kundër Terrorizmit, në kuadër të Takimit të dymbëdhjetë të Komitetit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian – Shqipëri.

- kontribuoi pranë MFE mbi “Risqet e identifikuara nga Vlerësimi Kombëtar i Riskut për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Analizat e Riskut”.
- realizoi raportime periodike për Kryenegociatorin mbi pasqyrimet dhe rekomandimet e progres raportit për “Kapitullin 24” dhe për “Kapitullin 31” si dhe për Ministrinë e Brendshme (MB) dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ).
- përcolli pranë Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes formatin tabelar mbi raportet kombëtare dhe ndërkombëtare të institucionit tonë.
- përcolli në mënyrë shkresore pranë Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH) raportin për muajt Tetor-Dhjetor në kuadër të procesit të ri-integrimit dhe rehabilitimit.
- hartoi një përmbledhje mbi rolin dhe impaktin e saj për partnerin LKGV në kuadër të projekt-programit "Ri-integrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria".
- përcolli pranë KQZ piken e kontaktit për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucionit, në kuadër të zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, më datë 6 Mars 2022.
- përcolli pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) “Raportin e menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2021”, “Planin e ngritjes dhe zhvillimit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit për vitin 2022” si dhe Pyetësorin e vetëvlerësimit.
- përcolli pranë Drejtorisë së Antiterrorit informacion mbi kapacitetet e saj institucionale në kuadër të Kapitullit 24 për nënfushën e Luftës Kundër Terrorizmit.
- vijoi me plotësimin e dosjeve fizike të shtetasve të riatdhesuar nga Siria dhe Iraku me informacion të përditësuar në kuadër të procesit të ri-integrimit që po zbatohet.
- përcolli pranë Zyrës së Menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm, Kryeministria dhe Agjencisë për Prokurimet Publike Tiranë, raportin "Mbi detajimin e buxhetit (Ilojin e investimit, fondin në dispozicion dhe afatin kohor kur pritet të shpallet procedura)"-Regjistri i Parashikimeve për Prokurimet Publike për vitin 2022.
- përcolli tek Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, informacionin mbi kërkesat për informacion publik të regjistruara në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve për periudhën Janar - Dhjetor 2021.

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm përgjatë periudhës së 6-mujorit të parë Janar-Qershor 2022, vlerëson si prioritete të rëndësishme të punës së saj, ndërhyrjet në drejtim të zbatimit të programeve rehabilituese dhe ri integruese që po i ofrohen shtetasve shqiptarë në komunitet si dhe shtetasve të kthyer nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak. Po ashtu është punuar për të zbatuar veprimtaritë e planifikuara me një qasje prioritare kundrejt komunikimit strategjik që duhet të ndërmerret në këtë drejtim. Hartimi i Planit të Veprimit 2022-2025 të QKEDH-së është një tjetër prioritet i rëndësishëm i institucionit tonë për ta finalizuar në bashkërendim me institucionet relevante të linjës. QKEDH-ja vazhdon punën koordinuese me QP, Durrës ku janë akomoduar të rikthyerit e operacionit të fundit nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak në Maj 2022, si dhe po mbikqyr dhe koordinon proceset e riintegritimit në komunitet të përfituesve të mëparshëm.

